

AKTI THEMELIMIT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“K & B., shpk,

(ne zbatim te ligjt n. 9901 date 14.04.2008)

me seli ne Tirane

Ne Tirane, sot me date 05.06.2018, ne Tirane, une

Znj. Eriona BITRAJ, e bija e Kujtimit dhe Donikes, lindur ne Tirane, me 01.06.1979, banuese ne Tirane, Rruga “Konferanca e Pezes,, nr. 3171, me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtese e leternjofimit nr. H95601098P,

perpilon

sa me poshte vijon:

1) E lartpermendura deklaron se themelon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin shoqeror: “K & B., Shpk.

2) Shoqeria ka si objekt te aktivitetit te saj:

- Aktivitet bar, restoran dhe aktivitet te ushqimit social ne per gjithesi.
- Aktivitet te ndertimeve te te cdo lloji, infrastrukture dhe ndertime mbitokesore, aktivitet mirembajtje dhe restaurimi objektesh dhe cdo aktivitet te lidhur me ndertimin, pa kufizim.
- Pjesmarrjen ne tendera publike e private per aktiviteqe qe lidhen drejteperdrejt apo terthorazi me aktivitetin e shoqerise.
- Aktivitet imobiliar si dhe cdo aktivitet tjeter te lidhur drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e shoqerise dhe qe i sherben permbushjes se objektit te shoqerise.
- Cdo aktivitet tjeter, qe lidhet direkt apo indirekt me aktivitetet e lartpermendura dhe qe lejohet nga legjislacioni ne fuqi.

3) Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i papercaktuar.

4) Selia e shoqerise eshte ne Tirane: Rruga “Zenel Baboçi”, Ndertesa nr.8, Njesia Administrative nr. 9.

5) Kapitali shoqeror eshte leke 100.000 dhe i nenshkruar plotesisht nga ortaku i vetem Eriona BITRAJ.

6) Kapitali shoqeror eshte i perbere nga 1 kuote e vetme, e mbajtur nga ortaku i vetem.

7) Shoqeria do te administrohet nga administratori i vetem te cilit i jane dhene te gjitha kompetencat e drejimit te zakonshem.

Administratori i vetem qendron ne detyre per nje mandat 5 – vjecar dhe per sa kohe nuk eshte revokuar nga ortaku i vetem si organi me i larte vendimmarres ne shoqeri.

Me kete akt, administrator i pare dhe i vetem i shoqerise emerohet **Znj. Eriona BITRAJ**, e bija e Kujtimit dhe Donikes, lindur ne Tirane, me 01.06.1979, banuese ne Tirane, Rruga "Konferanca e Pezes,, nr. 3171, me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit nr. H95601098P.

8) Vitet ushtrimore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Viti i pare ushtrimor mbyllte me 31 dhjetor 2018.

9) Vendbanimi fiskal i ortakut te vetem do te jete selia e shoqerise per cdo efekt ligjor.

Ky akt themelimi eshte hartuar ne Tirane ne pese ekzemplare me vlere te njejtë ligjore.

Shoqeria krijohet dhe do te ushtroje aktivitet ne perputhje me ligjet shqiptare ne fuqi, ligji n. 9901 date 14.04.2008 dhe ligje te tjera qe do te jene ne fuqi gjate periudhes se aktivitetit te shoqerise, si dhe ne perputhje me statutin qe konsiderohet pjese perberese e ketij akti dhe qe i bashkengjitet si ANEKSI B

Lexuar, gjetur konform vullnetit te lire e te pavesuar, pranuar dhe nenshkruar nga ortaku i vetem i shoqerise:

ORTAKU I VETEM

ERIONA BITRAJ

ERIONA BITRI

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'ERIONA BITRAJ' or a similar variation, written over the name 'ERIONA BITRI' which is underlined.

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“K & B,, shpk,
(ne zbatim te ligjit n. 9901 date 14.04.2008)

me seli ne Tirane

Ne Tirane, sot me date 05.06.2018, une,

Znj. Eriona BITRAJ, e bija e Kujtimit dhe Donikes, lindur ne Tirane, me 01.06.1979, banuese ne Tirane, Rruga “Konferanca e Pezes,, nr. 3171, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit nr. H95601098P

Vendosa te perpiloj statutin e shoqerise me pergjegjesi te lufizuar qe do rregullohet si me poshte vijon:

KREU I
Emertimi - objekti,
Selia – Afati
Neni 1

Eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin social “K & B,, Sh.p.k., me ortak te vetem Znj. Eriona BITRAJ.

Emertimi i shoqerise do te shfaqet ne te gjitha aktet qe do te dalin ne emer dhe per llogari te shoqerise. Ne kete statut shoqerise se lartpermendur do t'i referohemi si “Shoqeria”.

Neni 2

Shoqeria ka si objekt te aktivitetit te saj:

- Aktivitet bar, restoran dhe dhe aktivitet te ushqimit social ne per gjithesi.
- Aktivitet te ndertimeve te te cdo lloji, infrastrukturre dhe ndertime mbitokesore, aktivitet mirembajtje dhe restaurimi objektesh dhe cdo aktivitet te lidhur me ndertimin, pa kufizim.
- Pjesmarrjen ne tendera publike e private per aktivite te qe lidhen drejtperdrejt apo terthorazi me aktivitetin e shoqerise.
- Aktivitet imobiliar si dhe cdo aktivitet tjeter te lidhur drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e shoqerise dhe qe i sherben perm bushjes se objektit te shoqerise.
- Cdo aktivitet tjeter, qe lidhet direkt apo indirekt me aktivitetet e lartpermendura dhe qe lejohet nga legjislacioni ne fuqi.



Neni 3
Selia

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "Zenel Baboçi", Ndertesa nr.8, Njesia Administrative nr. 9.

Ortaku i vetem ka te drejte te hape seli te tjera sekondare, filiale, zyra perfaqesimi dhe agjensi si ne Shqiperi ashtu dhe jashte saj, madje dhe te transferoje seline e shoqerise, por kjo e fundit gjithsesi do te mbetet ne territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 4

Shoqeria eshte themeluar nga nje ortak i vetem, por ne te ardhmen ajo mund te kete dhe disa ortake.

Vendqendrimi zyrtar i ortakut te vetem, apo ortakeve te tjere, nese keta do te shtohen, ortakeve per cdo raport me shoqerine eshte selia e shoqerise.

Neni 5

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i papercaktuar.

Kreu II
Kapitali shoqeror dhe kuotat
Neni 6

Kapitali shoqeror eshte fiksuar ne leke 100.000 (njeqind mijë) dhe mund te rritet sipas modaliteteve ligjore.

Kapitali perbehet nga 1 kuote e vetme e mbajtur nga ortaku i vetem i shoqerise.

Neni 7

Kuota eshte e transferueshme mes te gjalleve me kontrate, mes ortakut dhe bashkeshorit te tij, ose me rruge trashegimie.

Neni 8

Financimet e bera nga ortaku i vetem, jane te lira nga interesat.

Kreu III
Administrimi
Neni 8

Shoqeria administrohet nga nje administrator i vetem, qe qendron ne detyre per nje afat 5-vjecar. Znj. Eriona BITRAJ eshte administratore e vetme e shoqerise.

Administratori ka kompetencia e plota lidhur me administrimin e zakonshem te shoqerise, me perfaqesimin e saj perball te treteve, perfshire gjykatat, bankat, entet publike apo private, institucioneve qendrore apo lokale, per marredhenie apo aktivitete ku shoqeria po te jete e perfshire ne menyre direkte apo indirakte.



Neni 9 Ortaku i Vetem

Te gjitha te drejtat, te te cdo lloji, te pakufizuara dhe te lidhura me drejtimin e zakonshem e te jashtezakonshem te te shoqerise, dhe qe synojne permbushjen dhe realizimin e objektit shoqeror te shoqerise i perkasin ortakut te vetem te shoqerise.

Shprehimisht, ortakut te vetem i njohen keto kompetencia:

Ndryshimi i Statutit te Shoqerise si dhe te perqindjes se pjesemarries se "Ortave", nese ne te ardhmen do te kete me shume se nje ortak.

Percaktimi i synimeve qe do te kete Shoqeria.

Miratimi i rezultateve vjetore te Shoqerise dhe emerimi i eksperteve kontabel.

Riorganizimi dhe shkrirja, ose mbyllja e Shoqerise.

Zgjedha e administratorit te Shoqerise.

Mundesa e ri-investimeve te fitimeve te saj ne territorin e Shqiperise para se te jete parashtruar nga administratori.

Miratimi i raportit vjetor te punes se kryer nga administratori i Shoqerise.

Administrimi i pasurise se Shoqerise.

Miratimi i cdo lloj garancie te ofruar nga Shoqeria (Hipoteke, pengu) ne formen e se drejtes se posedimit te pasurise se Shoqerise si dhe garancive te tjera qe kane te bejne me debitet e Shoqerise ne baze te Legjislacionit ne fuqi. Percaktimi i nivelit te pages se administratorit dhe te eksperteve kontabel.

Ortaku i vetem percakton shpenzimet lidhur me aktivitetin, miraton buxhetin e shpenzimeve rrjedhese, raportin vjetor te administratorit, dhe raporte te tjera ekonomike qe parashikon ligji. Ortaku i vetem percakton ndarjen ne pjese te fitimit dhe llogaritjen e sakte te humbjeve brenda afatit gjashte-mujor nga mbarimi i vitit ekonomik, miraton rrogat e personelit si dhe numrin e personelit.

Emerimin dhe shkarkimin nga detyra te administratorit dhe te eksperteve kontabel.

Neni 10

Administratori ka te drejten e firmes perfaqesuese te shoqerise perballte te treteve dhe ne gjykim, me te drejten qe te krye veprime, procedura ne shkalle te ndryshme gjyqesore dhe administrative, si dhe te mirekuptohet, keshillohet dhe te arrije ne marreveshje.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE Neni 11

11.1 Viti finanziar fillon me 1 janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te secilit vit.

11.2 Viti i pare finanziar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.

11.3 Bilancet vjetore, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar, nese eshte emeruar, miratohen nga Ortaku i Vetem sipas ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".



11.4 Miratimi i dokumenteve qe lidhen me vitin finaciar duhet te behet brenda 6 muajve nga fundi i vitit finanziar.

Neni 12

12.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% te destinuara per rezerven ligjore deri ne 10% te kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu te gjitha shumat qe Ortau i Vetem vendos te vere menjane, i kalojne ortakut te vetem.

12.2 Ortaku mund te vendose dhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo per shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardshme.

KAPITULLI V SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 13 – Prishja

Shoqeria prishet me ane te Vendimit te Ortakut te Vetem.

Neni 14 – Likuidimi

14.1 Ne rast prishje, shoqeria duhet te likuidohet.

14.2 Per te administruar kete procedure, Ortaku i Vetem emeron nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe te pasivit te shoqerise, mbi operacionet e likuidimi dhe mbi kohen e nevojshem per te perfunduar likuidimin.

14.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit, Ortaku do te vendose mbi bilancin finanziar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.

14.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do te shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ne favor te ortakut te vetem.

Neni 15- Gjykata Kompetente

Gjykate kompetente per zgjidhjen e cdo konflikti ne shoqeri, te shoqerise me subjekte te tjere: individ, persona fizike dhe juridike do te jee Gjykatë e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 16 – Gjuha

16.1 Ky statut eshte i shkruar ne 5 (pesë) kopje ne gjuhen shqipe.

Lexuar, gjetur konform vullnetit te lire e te pavesuar, pranuar dhe nenshkuar nga ortaku themelues:

ORTAKU THEMELUES

ERIONA BITRAJ
ERIONA BITRAJ
